b) Për kontrata për punë publike është realizuar me subjekte private kërkohen :

- Kontraten/at e Sipërmarrjes,
 - Situacion përfundimtare të objektit,
 - Faturat tatimore për çdo situacion,
 - Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojces nr.9.
 - Akti i Kolaudimit
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim.
1. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertues ku te deklarohet se, brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. *Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej*

anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë. (Sipas Shtojcës 11).

2. Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zotërojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuar me ligj si më poshtë:

- **NP-1 A** Punime germimi ne toke
- **NP-2 C** Ndërtime civile dhe industriale
- **NP-3 C** Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale
- **NP-11B** Ndertime per N/stacione,kabinat e transformatoreve linja TN te mesem dhe shperndarjen e energjise
- **NP-12 A** Punime te inxhinierise se mjedisit
- **NS -1 A** Punime per prishjen e ndertimeve
- **NS- 2 B** Impjante hidrosanitare,kuzhina,lavanteri mirembajtje
- **NS – 3 A** Impiante ngritese dhe transportuese
- **NS -4 B** Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to etj
- **NS-14 B** Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radoitelefoni TV etj
- **NS-16 A** Ndertimi i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij
- **NS-17 A** Ndertimi i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane
- **NS-18 A** Punime topogjeodezike
- **NS-19 A** Sistemet kundra zhurmes per infrastrukture

3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë dhe të jenë të punësuar për periudhën Shkurt 2018-Shkurt 2019, Inxhinierët e mëposhtëm:

- | | |
|--------------------------|---------|
| 1) Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| 2) Inxhinier Ndertimi | 2 (dy) |
| 3) Inxhinier Mekanik | 1 (një) |
| 4) Inxhinier Topograf | 1 (një) |
| 5) Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| 6) Inxhinier Mjedisi | 1 (një) |
| 7) Inxhinier Gjeolog | 1 (një) |
| 8) Arkitekt | 1 (një) |

Për inxhinieret e mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune noteriale e vlefshme, CV, Diplomë,
- Listepagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 për periudhën e kërkuar.

6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të Administratorit të shoqërisë Drejtuesin/(t) Teknik të punimeve në objekt, i cili do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

Diplomë, Kontratë pune, CV, te figuroje ne listëpagesat Shkurt2018 – Shkurt 2019.

- 7.Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata tatimore për punesimin mesatar jo më pak se 145 punonjës për periudhen Shkurt 2018- Shkurt 2019 shoqëruar me

Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Shkurt 2018- Shkurt 2019

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik 90 punonjës, të pajisur me certifikata të sigurimit teknik ose certifikata ekuivalente të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht minimumi:

- 2 (dy) Teknikë të mesëm ndërtimi me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish(IQT).
- 10 (dhjete) Punonjës bojaxhi me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish (IQT).
- 12 (dymbëdhjete) Punonjës elektrikist me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish(IQT).
- 7 (shtatë) Punonjës hidraulik me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish(IQT).
- 10 (dhjete) Punonjës specialist ndërtimi me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish (IQT).
- 8 (tete) Punonjës hidroizolues me kualifikime teknike lëshuar nga institucionet e autorizuar nga ISHTI /ish(IQT).
- 1 (nje) Punonjës elektro-mekanik me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish (IQT).
- 2 (dy) Punonjës mekanik me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish (IQT).
- 4 (kater) Punonjës hekurkthyes me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish (IQT).
- 5 (pese) Punonjës murator me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish (IQT).
- 5 (pese) Punonjës saldatorë me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish (IQT).
- 6 (gjashte) Punonjës pllaka shtrues me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish(IQT).
- 6 (gjashte) Punonjës karpentier me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish(IQT).
- 4 (kater) Punonjës Suvaxhi me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish(IQT).
- 4 (kater) Punonjës Manovratore me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI dhe Patente Manovrimi nga DPSHTRR.
- 1 (nje) Punonjës Automakinist me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI dhe Patente Manovrimi nga DPSHTRR.
- 3 (tre) Punonjës Shofere me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të autorizuar nga ISHTI /ish(IQT).

❖ Per punonjës të teknik si me sipër, të paraqitet Kontrata e punës e vlefshme, certifikatat përkatëse dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

9. Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij teknik (përfshirë në Listëpagesë) një inxhinier elektrik të pajisur me Çertifikatë të Sigurimit Teknik nga IQT- me Grupin V, si dhe të jetë i pajisur me

license profesionale ing elektrik (të paraqesë kontraten e punes, diplomen).

10. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar te vertetuar me kontrate pune të vlefshme dhe të figurojnë në listepagesat e shoqerisë të paktën 12 punonjës specialistë të certifikuar për punime që do të kryhen në lartësi , të pajisur me Certifikatat e Punimeve në lartësi D.P.I.

11. Te kete ne listepagese mjekun e shoqerise te kete kontrate pune, diplome, license, Urdher Mjeku. Mjeku i punës duhet të figurojë në listapagesa, në referencë të numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër

- ❖ Ne rast bashkimi operatoresh ekonomik, secili nga operatorët ekonomik duhet ta plotesoje kete kusht.

12. Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten drejtuesin teknik te shoqerise (nje person) qe te disponoje certifikata e trajnimit si "Per pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e e rregullores "Per sigurine ne kantier".

13 Operatori ekonomik te kete ne stafin e tij 1 (nje) punonjes i pajisur me certifikate "Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave", e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise,

14 Operatori ekonomik pjesmarrës të ketë në staf të punësuar si më poshtë si dhe të rezultojnë në listpagesat e shqërisë:

a) Inxhinier – Auditues energjie 1 person (i pajisur me "Certifikate per auditimin e energjise) Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te kete keto dokumenta provues:
-Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit),
-Certifikata (Dip) per eficensen e energjise.

c) Inxhinier mjedisi i pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Audit mjedisor duhet te kete keto dokumenta provues:
-Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit)

15. Operatori ekonomik te kete ne stafin e tij 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin.

- *Ne mbeshet te pikes 4 te nenit 49 te Ligjit Nr. 152/2015 Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin," te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata perkatese e dhene nga Drejtoria e MZSH.*

16. Operatori ekonomik te kete Liçense profesionale nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi 1.2.A. per Mbrojtjen nga Zjarri .

17. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B“Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeje Urbane

- *Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeje te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat,autorizimetdhe lejet ne Republiken e Shqiperise”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25*

18. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- a) ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise)
- b) ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor)
- c) OHSAS 18001- 2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune)
- d) ISO 39001-2012 (Sistemi i Menaxhimit te Sigurise se Trafikut Rrugore)
- e) PAS 99 :2012 (Sistemi i Integruar i Menaxhimit)
- f) ISO 50001:2011 (Sistemi i Menaxhimit te Energjise)
- g) ISO 27001:2013 (Sistemi i Menaxhimit te Sigurise te Informacionit)
- h) ISO 3834-2:2006 (Kerkesat e cilesise per saldim me shkrirje te materialeve metalike)

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese keto certifikata, ISO sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër ne aktmarrëveshjen e bashkepunimit.

- Për materialet (elektrike, hidraulike, hidrosanitare, pllaka, kolle, bojak, d/alumin, ndriçues Led, gipse, primer katrama, hidroizolues AB,rezinat,pompat,bojrat,rezervuar lende djegese,sistem i ngrohjes/ftohjes, sistem mbrojtje k/zjarrit, sistemi kamerave, impiantin e gazeve mjekesore dhe paisjet mjekesore,sistemi kapot), operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit .
- ❖ Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

➤ **Për materialet Elektrike (automatet):**

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën e Konformitetit CE, IEC60898-1 ose ekuivalente dhe ICE 60947-2 ose ekuivalente.

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportin e testimit i cili duhet të jetë kryer nga laboratorë testues të çertifikuar me ISO 17025:2005 ose ekuivalente nga institucione kombëtare

ose ndërkombëtare të akreditimit, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike.

➤ **Për materialet Hidraulike:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë për tubat PPR që vërteton se tubat janë për përdorim për ujë të pijshme, kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga institucione ndërkombëtare ose kombëtare.

➤ **Për materialet Hidrosanitare:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportet e testimit të cilat duhet të jetë kryer nga laboratorë testues të certifikuar nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike.

➤ **Për materialet e bojës:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument nga organet shtetërore certifikuese të vendit të origjinës së prodhimit të bojës ku të vërtetohet që boja hidroplastike është bojë ekologjike (certifikimi ECO).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët/ose fragmente të katalogut të bojërave, skedat teknike si dhe raportet e testimit nga laboratorë të certifikuar sipas ISO 17025:2005 ose ekuivalente nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike.

➤ **Për impiantin e gazeve mjekësore dhe paisjet mjekësore**

-Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument nga organet shtetërore që paisjet mjekësore janë të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet dokument lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve: Mjekësore Certifikatë Regjistrimi në përputhje me ligjin 89/2014 “Për paisjet mjekësore”

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë furnizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me të cilin prodhuesi/distributori i autorizuar autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje në këtë procedure

➤ **Per rezervuarin e lendes djegese:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;Dokumentin e testimit të ljerjes së jashtme;Dokumenti i testimit hidrostatik;Certifikate kalibrimi;Certifikaten e inspektimit të materialit të përdorur.

- j. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
----	---------------	-------	------	---------

Dokumenta Standarde të Tenderit

1	Eskavator me zinxhirë	Copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Eskavator me kovë dhe çekiq pneumatik	Copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Eskavator mbi 50 ton me krah mbi 20 m, me kove, me nofulla shtrenguese per prishje (demolim)	Cope	1	Në pronësi ose me qera
4	Kamiona vetshkarkues min 14 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
5	Kamion vetshkarkues min 5 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qera
6	Kamioncine (kapaciteti total mbajtës minimumi 1-3 ton)	Cope	2	Në pronësi ose me qera
7	Fadrome	Copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Mini Fadrome		1	
9	Gjenerator 100 kwa	Copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Pompa Uji	Copë	2	Në pronësi ose me qera
11	Depozitë Uji (5000 Litra)	Copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Betoniëre	Copë	4	Në pronësi ose me qera
13	Autobetoniëre	Copë	3	Në pronësi ose me qera
14	Autopompë Betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Vinc karel (portativ) i levizshem me kapacitet 0.3 ÷ 0.5 ton:	Copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Pompe Suvatimi	Copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Saldatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Vibrator	Copë	3	Në pronësi ose me qera
19	Skela metalike te kompletuara me parapet mbrojtës, shkalle dhe rrjete mbrojtëse	M ²	2000	Në pronësi ose me qera
20	Armatura druri (betoforma)	M ²	1000	Në pronësi ose me qera
21	Paisje për hekurkthyes (tranxhe / elektrobango)	Copë	1	Në pronësi ose me qera
22	Pajisje niveluese per nivelim shtresash	Copë	1	Në pronësi ose me qera
23	Autobitumatrice	Cope	1	Në pronësi ose me qera
24	Autobot Uji	Copë	1	Në pronësi ose me qera
25	Buldozier	Copë	1	Në pronësi ose me qera
26	Rul	Copë	1	Në pronësi ose me qera
27	Greider	Copë	1	Në pronësi ose me qera
28	Nyje inerte e paisur leje mjedisore	Copë	1	(kontrate furnizimi)
29	Nyje betoni e pajisur me leje mjedisore	Cope	1	(kontrate furnizimi)

21. Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 100 (njqind) copë

- Jelekë minimumi 100 (njqind) copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 (dhjetë) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 10 (dhjetë) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 (Njëzetë) copë
- Karroca dore minimumi 10 (dhjetë) cope

Makineritë dhe paisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie original ose fotokopje e noteruar.

- a) Makineritë dhe paisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje të lidhura para noterit publik me emër objekti, si dhe të shoqërohen me aktin e pronësise të qiradhënësit (orgjinal ose fotokopje e noteruar).
- b) Kontrata e qirasë për makinerite në fjalë duhet të jetë e shtrirë në një kohë përtej afatit të përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet.
- c) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti). Për paisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, orgjinale ose fotokopje e noteruar. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara të jenë të shoqëruara me foto.
- d) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme.

22.Cdo ofertues do të paraqesë PLAN - ORGANIZIMIN te punimeve ne objekt ku te reflektoje te gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjere qe kerkon nje plan organizimi i mirfillte.

23.Cdo ofertues do të paraqesë edhe Grafikun e Punimeve në përputhje me afatin e realizmit të punimeve brenda 21 muajve nga data e nënshkrimit të kontrates.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj: **Projekti dhe planimetritë, skicat bashkelidhur.**



Specifikimet Teknike të Materialeve: **Specifikimet teknike bashkelidhur.**

Grafiku i Punimeve: **Bashkelidhur.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Prevetivi i punimeve pa çmime bashkelidhur dokumentave te procedures se prokurimit.



Shtojca 15

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra* *[_____]* është identifikuar si oferta e

suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____



[Titullari i autoritetit kontraktor]

Public Health Sector

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: d oferta ekonomikisht më e favorshme dçmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Dokumenta Standarde të Tenderit

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS **Punët – Procedura e Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndërtimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndërtimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtnes projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit

të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhvishjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukuara që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

- 17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

- 18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

- 19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .
- 19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

- 20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

- 21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.
- 21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.
